# Plagoset 26 vjeçari në Prizren, sekuestrohet një AK-47

LAJME




06/03/2025 10:15

**Të shtëna me armë zjarri pati në orët e vona të natës së kaluar në Prizren.**

Pas një fjalosje në mes të disa personave, i dyshuari Z.T, 31 vjeçar ka shkrepur me armë zjarri në drejtim të viktimës Y.G, 26 vjeçar.

Sipas policisë, viktima është plagosur në këmbë dhe është dërguar në emergjencën e Spitalit Rajonal të Prizrenit, kurse policia sapo e ka marrë informatën kanë shkuar në drejtim të vendit të ngjarjes, transmeton lajmi.net.

Rasti ndodhi në rrugën "Durrësi".

"Me kohë janë njoftuare dhe Sektori i Hetimeve të stacionit dhe hetuesit e Sektorit Rajonal të hetimeve të cilët kanë dal në vend ngjarje dhe kanë mbledh provat dhe dëshmitë.  I dyshuari është vetëndezur dhe ka dorëzuar armën që dyshohet se është përdorur për kryerjen e veprës penale, një AK 47 gjinden në trajtim mjekësor, gjendja e tyre sipas mjekut kujdestar është jashtë rrezikut për jete, kurse të dyshuarit tjerë janë në kërkim", thuhet tutje në njoftimin e policisë.

Në cilësinë e provës materiale janë sekuestruar :

-Pushkë automatike me numër serik AK -47;

-2 karikatorë;

-7 fishekë te kalibrit te panjohur;

-1 gëzhojë.

I dyshuari është intervistuar në prezencën e avokatit, në konsultim me prokurorin kujdestar rasti është cilësuar si "Vrasje në tentative " dhe "Mbajtje në pronësi. kontroll, posedim apo shfrytëzim i pa autorizuar i armës".**/Lajmi.net/**

Më shumë nga uebi

nativeGRAM by LuponMedia


https://insajderi.org/ske e-shpelarjes-se-parave-


Qysh po i avancon Kurti njerëzit e ndërlidhur me


Vajza e Hamëz Jasharit ia thotë këngës për


Gjykata merr vendim, me kaq vite dënohet


"Ti je gjithmonë fituesi im", lajmërohet me në

## LAJME TË FUNDIT


Tjetër takim: Zyrtarët ukrainas dhe amerikanë pritet të...


Nënpresidenti i ShBA-së, JD Vance viziton kufirin me Meksikën


Paralajmëron Kurti: Rrezikun e një agresioni të hapur...


"Made in Kosova" – Maqedonci thotë se së...

## Artikuj të ngjashëm


March 6, 2025

Tjetër takim: Zyrtarët ukrainas dhe amerikanë pritet të takohen javën tjetër...



©Copyright lajmi.net 2022. All Rights Reserved Privacy Policy